

BARAZIA, SYNIM I DEMOKRACISË



TË DREJTAT TONA NË DEMOKRACI

VESA (10), LATIF (11), DILARA (10), DIAR (11), ARSA (11), EMSAR (10), GAMZE (10), DENIS (10),

ERBLINA (11), ERDALL (11)



Duke i respektuar elementet e demokracisë, ne do të jemi qytetarë më të mirë

Të gjithë njerëzit në mbarë botën kanë të drejta dhe përgjegjësi. Kjo ndodh duke iu falenderuar formës së qeverisjes të quajtur demokraci. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull, dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje apo qeverisje. Demokracia ka forma të ndryshme, por format më të rëndësishme janë: demokracia e drejtëpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Ndërkaq, demokracia përfaqësuese ka dy sisteme: sistemin parlamentar dhe atë presidencial. Në shtetin tonë e kemi demokracinë përfaqësuese me sistemin parlamentar, ku ne jemi ata të cilët i zgjedhim përfaqësuesit tanë përmes votave tona. Ne jemi dëshmitarë se demokracia ka shumë gjëra të bukura, të cilat na bëjnë neve që të kemi një jetë më të mirë. Për shembull, komunikimi me respekt ndërmjet

njëri-tjetrit, ku secili prej nesh mund të flasë lirshëm. Përveç respektit, ndjenjën e barazisë na jep edhe fakti që të gjithë e kemi të drejtën të shkollohemi pa dallim race, feje, gjinie, komuniteti, etj.

Demokracia na siguron neve të drejta të shumta siç janë: e drejta për tu shprehur lirshëm kudo që shkojmë, e drejta për të votuar një përfaqësues siç është kryetari i klasës, kryetari i qytetit, kandidatët për deputetë. Megjithatë këto zgjedhje bëhen varësisht prej moshës që ne kemi.

Ne jemi të lumtur që sot patëm mundësinë të njoftohemi më shumë për të drejtat tona si qytetarë të një shteti demokratik siç është Kosova.

Megjithatë, lexues të dashur ne gjithashtu kemi edhe përgjegjësitë tona që duhet t'i kryejmë kudo që ndodhemi, në shtëpi, në lagje, në shkollë apo kudo tjetër.



Gazetarët demokratë



Duke i kryer detyrat e punës në grup

TË GJITHË E KEMI TË DREJTËN E VOTËS


ERA (11), ERMELINA (10), LENA (10), ERZA (10), KRENARE (10), OLTA (11), SARA (10), AMAR (11)

ALBAN (10), VENET (11)


Në demokraci të gjithë e kemi të drejtën e votës. Kjo e drejtë në Kosovë itakon çdo qytetari aktiv i cili mendon për të ardhmen e shtetit të tij. Ne çdo ditë votojmë, për shembull çdo ditë zgjedhim veshjen tonë. Mirëpo, për të marrë pjesë në zgjedhjet shtetërore duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare. Arsyeja se pse kemi të drejtë të votojmë në këtë moshë është sepse atëherë jemi më të pjekur dhe e dimë më mirë se kë duhet ta votojmë. Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe zgjedhjet lokale. Në zgjedhjet qendrore populli zgjedh deputetët, kurse në ato lokale populli zgjedh kryetarin e komunës dhe asambleistët e saj. Pra, roli i secilit qytetar është shumë efektiv, sepse vet ata i zgjedhin përfaqësuesit e vendit. Sugjerimi ynë për qytetarët është dashurështë: votoni personat që mendoni se do ta udhëheqin shtetin tonë më së miri.




E ardhmja e vendit jemi ne gazetarët e demokracisë




Të gjithë kemi të drejtën e votës në moshën 18 vjeçare





Liria dhe paqja janë dy prej elementeve të demokracisë



Të gjithë jemi të barabartë



Me anë të votës i zgjedhim deputetët



DEPUTETËT E ARDHSHËM

ANZOTIKA (11), AMAR (10), EMIR (11), EDONITA (10), INHARE (10), LIRIM (10), LIBURNA (10)

MERIS (11)



Artikulli ynë do t'iu informoj për punën që bën Kuvendi i Kosovës

Të dashur lexues, nga nëntitulli mund të kuptoni se tema jonë sot është Kuvendi dhe rëndësia e tij si institucion. Ne, edhe pse jo të moshës madhore do t'iu tregojmë disa fakte rreth Kuvendit të Kosovës dhe që shpresojmë që do t'iu ndihmojnë të keni një mendim më të qartë për këtë institucion.

Kuvendi, është institucioni më demokratik në vendin tonë, kjo sepse së pari, në Kuvend punojnë përfaqësuesit e popullit të cilët janë të zgjedhur me vota të lira. Qytetarët mbi moshën 18 vjeçare i votojnë ata për të cilët mendojnë se e meritojnë të quhen përfaqësues të popullit. Por shtrohet pyetja, në cilat zgjedhje populli i zgjedh apo voton për këta përfaqësues? Ne iu përgjigjemi kështu: pasi që në vendin tonë kemi dy lloje të zgjedhjeve, populli përfaqësuesit e vet i voton në zgjedhjet qendrore.

Si i tillë që është, Kuvendi ka disa funksione të cilat janë: përfaqësimi i popullit, që nënkupton se deputetët e kanë të rregulluar me Kushtetutë të përfaqësojnë popullin që i ka votuar. Pastaj funksion tjetër i Kuvendit është t'i miratoj projektligjet të cilat propozohen nga: deputetët, Qeveria, Presidenti si dhe një numër i madh i qytetarëve. Edhe pse, jo gjithmonë këto projektligje miratohen. Po ashtu, Kuvendi ka edhe

një funksion, e që është mbikëqyrja e Qeverisë. Përpos këtyre që i cekëm, ky institucion ka edhe shumë detyra të tjera dhe përgjegjësi.

Në Kuvend kuvendojnë 120 deputetë të cilët janë të zgjedhur me vota të lira. Prej këtij numri të madh të deputetëve, 100 janë të etnisë shqiptare, ndërsa 20 iu takojnë etniteteve të tjera, si: romë, ashkali, egjiptianë, serbë, boshnjakë si dhe turq. Pra, nga kjo kuptojmë se ky institucion paska frymë demokratike sepse të gjithë deputetët janë të barabartë, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të tyre. Ne shpresojmë që, pasi të keni përfunduar së lexuari këtë artikull, t'i përshtypni vetes: „Ah, sa gjëra të nevojshme dhe të rëndësishme kam mësuar për Kuvendin!“



Puna jonë në grup



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Naim Frashëri“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Vushtrri